



## KESHILLI I BASHKISE KORÇE

### VENDIM

Nr. 48 / 20.5.2009

### **Për akordimin e fondit prej 428 500 lekë, për realizimin e Konkursit ndërkombëtar të fotogtafisë ‘Sotir’**

Këshilli i Bashkisë së qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit “Për akordimin e fondit prej 428 500 lekë per realizimin e Konkursit ndërkombëtar të fotogtafisë ‘Sotir’

Mbështetur në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika “dh”, ligjit nr 8399 dt. 09.09.1998 “Për buxhetin lokal”, Ligjit nr 10025 dt. 27.11.2008 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2009", Udhëzimit nr 2 dt. 12.01.2009 te M.F. “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2009, si dhe V.K.B. nr. 12 dt. 13.02.2009 “Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008”, si dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve:

#### **VENDOSI:**

1. Të miratojë akordimin e fondit prej 428 500 lekë, i cili përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të bashkisë me këtë strukturë buxhetore dhe që do të shpenzohet sipas detajimit bashkëngjitur.

Pakësohet	00	04980	05	art	609 0000 – 428 500 leke
Shtohet	00	08250	05	art	602 0000 + 428 500 leke

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit, Drejtoria e Finances dhe Qendra Kulturore “Vangjush Mio”

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

*Raimonda NASE*  
**Raimonda NASE**